



Project funded by EU




DOKUMENT POLITIKASH DHE REKOMANDIMET

mbi përfshirjen sociale

të personave me aftësi të kufizuar

dhe çrregullime të shëndetit mendor

në Kosovë





Project funded by EU



DOKUMENT POLITIKASH DHE REKOMANDIMET

mbi përfshirjen sociale
të personave me aftësi të kufizuar
dhe çrregullime të shëndetit mendor
në Kosovë

*Bazuar në rezultatet e diskutimeve gjatë takimeve të
Grupit Punues, të cilat janë realizuara në kuadër të projektit SOCIETIES*

Caritas Kosova, Prishtinë, Qershor 2019

Përgatitur nga: Ardiana Bytyçi

PËR DIJENI:

Projekti SOCIETIES financohet në kuadër të Programit të Bashkimit Evropian për Barazinë Sociale dhe Mediat 2014-2015 - Mbështetje për rrjetet tematike rajonale të Organizatave të Shoqërisë Civile. Mendimet e shprehura në këtë dokument bazohen në diskutimet dhe referencat e përmendura nga pjesëmarrësit gjatë takimeve të grupeve të punës të organizuara gjatë zbatimit të projektit, dhe për rrjedhojë nuk paraqesin domosdoshmërisht mendimet e institucioneve mbështetëse, përfshirë Bashkimin Evropian, projektin SOCIETIES, Caritas Kosova apo organizata të tjera partnere në këtë projekt.

Hyrje

Caritas Kosova, së bashku me 15 organizata partnere, ka implementuar projektin SOCIETIES - **Mbështetjen e OSHC-ve në Fuqizimin e Aftësive Teknike, Përfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe standardet e BE-së në Evropën Juglindore.** Ky projekt katërvjeçar i financuar nga Komisioni Evropian (2015 / 370-229) është duke u zbatuar që nga viti 2016 në pesë vende të Evropës Juglindore me mbështetjen e ekspertëve nga Italia dhe Bullgaria. Projekti përfshin 7 organizata Caritas: Caritas Kosova, Caritas Shqipëri, Caritas Mali i Zi, Caritas Bosnja dhe Hercegovina, Caritas Serbia, Caritas Italy dhe Caritas Bulgaria.

Projekti synon të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) në Evropën Juglindore për të ndikuar në proceset e vendimmarrjes dhe promovimin e politikave sociale nëpërmjet pjesëmarrjes në debate publik dhe dialog me autoritetet.

Të dhënat primare dhe rekomandimet e paraqitura në këtë dokument bazohen në tetë takime të Grupit Punues për Përfshirjen Sociale që u krijuar në kuadër të projektit SOCIETIES me një numër prej 30 pjesëmarrësve që përfaqësojnë institucione të ndryshme në nivel qendror dhe vendor si dhe OSHC. Të dhënat dytësore janë mbledhur para mbledhjeve të grupeve punuese nga vlerësimet e mëparshme, raportet e institucioneve dhe shoqërisë civile, shkollave, dhe dokumenteve dhe raporteve ligjore.

Caritas Kosova do të paraqesë konkluzionet dhe rekomandimet e këtij dokumenti në Forumin Kombëtar “Përfshirja Sociale e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Personat me Çrregullime të Shëndetit Mendor”, organizuar në kuadër të projektit SOCIETIES, më 7 qershor 2019 në Prishtinë. Dokumenti përfundimtar do të përfshijë rekomandime konkrete për përmirësimin e gjendjes së personave me aftësi të kufizuara dhe çrregullime të shëndetit mendor, të cilat do t’u prezantohen të gjithë akterëve të përfshirë në fushën e aftësisë së kufizuar dhe shëndetit mendor, si një kontribut në krijimin e politikave, rregulloreve dhe përmirësimit të praktikave në fushën e mbrojtjes sociale të këtyre kategorive të ndjeshme.

Të dhënat e paraqitura në këtë dokument janë një përmbledhje e përvojave ditore dhe sfidave të praktikuesve dhe ekspertëve të fushës dhe nuk paraqesin një analizë të problemeve në një kontekst më të gjerë.

Profili i Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë

Numri i personave me aftësi të kufizuara në Kosovë është i panjohur. Ndonëse të dhëna janë grumbulluar gjatë viteve të fundit, nuk ka numër të saktë që mund të mbështesin vendimmarrjen e bazuar në të dhëna, sepse definicione të shumta të aftësisë së kufizuar janë në përdorim nga institucione të shumta dhe palë të interesuara. Identifikimi i personave me aftësi të kufizuara ndjek modelin mjekësor dhe bazohet në një mendim mjekësor në lidhje me dëmtimin, sesa në një vlerësim holistik, që merr në konsideratë vlerësimin e profesionistëve të shumtë nga një sërë fusha studimi/sectorë. Legjislacioni ekzistues që rregullon identifikimin e aftësisë së kufizuar nuk fokusohet tek fëmijët; ai pothuajse përdoret gjithmonë në aspektin e përfitimit monetar - skemës së ndihmës sociale. Fëmijët me aftësi të kufizuara identifikohen më së shumti kur arrijnë moshën shkollare dhe përpiqen të regjistrohen në shkollë, kohë kjo kur intervenimi është tepër vonë për të pasur një ndikim të qëndrueshëm në zhvillimin e tyre¹.

Regjistrimi i popullsisë dhe banesave në Kosovë i vitit 2011 grumbulloi të dhëna në lidhje me aftësinë e kufizuar duke shfrytëzuar një sërë pyetjesh që u përpoqën të përcaktonin numrin e personave që raportojnë një vështirësi afatgjatë, në vend që të pyesin për aftësinë e kufizuar². Pyetjet përfshinin identifikimin 1) shurdhimin ose dëmtimin e rëndë të dëgjimit; 2) verbëri ose dëmtime të rënda të shikimit; 3) gjendje që kufizon ndjeshëm një ose më shumë aktivitete themelore fizike siç janë ecja, ngjitja e shkallëve apo ngritja e peshave; 4) paaftësi intelektuale apo në të mësuar; 5) një vështirësi afatgjatë psikologjike ose emocionale; dhe 6) të tjera, duke përfshirë çdo sëmundje të afatgjatë. Sipas rezultateve të Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave të vitit 2011, numri i fëmijëve të moshës 0 deri në 14 vjeç të raportuara me një ose më shumë vështirësi të afatgjata është 3,298. Ndërsa, 1,555 fëmijë të moshave 15-19 vjeç janë raportuar me një ose më shumë vështirësi dhe 1,639 të rinj të moshave 20-24 vjeç me një ose më shumë vështirësi të raportuara. Numri rritet ndjeshëm në mes të moshave 55 dhe 69 dhe pastaj pëson rënie përsëri. Në të gjitha kategoritë, numri i meshkujve të raportuar është më i lartë se femrat; ndërkohë që kategoria më e përfaqësuar e vështirësive afatgjata është gjendje që kufizon ndjeshëm një ose më shumë aktivitete themelore fizike.

Vështrim mbi gjendjen e PAK në Kosovë

Zbatimi i kornizës ligjore dhe qasja në shërbime publike

Autoritetet e Kosovës janë angazhuar në krijimin e infrastrukturës dhe politikave të nevojshme ligjore për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, si në nivel qendror e poashtu edhe në atë lokal të qeverisjes³. Megjithatë, sipas Raportit të KE-së për Kosovën 2019, pak përparim është bërë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe integrimi i tyre në shoqëri mbetet një sfidë për shkak të mbështetjes së kufizuar, shërbimeve joadekuante shëndetësore dhe qasjes së dobët në shërbimet ekzistuese. Korniza ligjore për shëndetin mendor është gjithashtu e mangët. Zbatimi i Ligjit për Personat e Verbër dhe Ligji për Statusin e të Drejtave të Personave me Paraplegji dhe Tetraplegia është i kufizuar. E njëjta vlen edhe për Strategjinë 2013-2023 për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara⁴.

Nuk ekziston një ligj gjithëpërfshirës për aftësinë e kufizuar; ndërsa ligjet specifike, p.sh. Ligji për Personat e Verbër, nuk janë vërtet të favorshëm për grupe të caktuara. Ministria e Punës dhe

1 UNICEF(2017). Situation Analysis: Children with Disabilities in Kosovo.

2 Kosovo Agency of Statistics (2011) Kosovo Population and Housing Census 2011 – Final results. Census Project Multi-Donor Trust Fund. Prishtina, Pg. 118.

3 Office for Good Governance. National Strategy on the Rights of Persons with Disabilities in the Republic of Kosovo (2013).

4 European Commission. Kosovo Report (2019).

e Punës Sociale ka parashikuar hartimin e koncept dokumentit mbi ligjin gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuara me qëllim të avancimit të kornizës ligjore.

Megjithë çështjen e zbatimit të legjislacionit ekzistues kombëtar, qasja fizike në ndërtesat publike, duke përfshirë shkollat dhe transportin mbetet e kufizuar për personat me aftësi të kufizuara. Rrjedhimisht, qasja fizike u theksua si pengesë edhe në qasjen në shërbimet publik.

Rekomandime:

- Realizimi i aktiviteteve avokuese me aktorët relevantë institucional për zbatimin më të lartë të kornizës ligjore ekzistuese;
- Realizimi i aktiviteteve avokuese me aktorët relevantë institucional me qëllim të marrjes së hapave konkrete në përmirësimin e infrastrukturës fizike për qasje më të mirë në shërbimet publike nga PAK.

Ofrimi i shërbimeve të specializuara dhe kujdesi afatgjatë

Shumë nga shërbimet mbështetëse që kërkohen për të siguruar jetesë të pavarur të PAK nuk janë në dispozicion në Kosovë. Shërbimet e specializuara rehabilituese, p.sh. shërbimet psikologjike, puna sociale, logopedia, fizioterapia, sigurohen nga OShC-të lokale me kapacitete shumë të kufizuara për shkak të pamundësive financiare.

Sipas Raportit të KE-së për Kosovën 2019, planifikimi gjithëpërfshirës dhe buxhetimi për ndërrhyrjet e duhura dhe ofrimin e shërbimeve duhet të realizohen si për të rriturit ashtu edhe për fëmijët.

Nga ana tjetër, sa i përket kujdesit dhe akomodimit afatgjatë, Kosova mbetet një nga praktikantët më të mira në rajon me 19 institucione të shëndetit mendor dhe të kujdesit social: 9 institucione të kujdesit social / shtëpi komunitare, 9 institucione të shëndetit mendor / shtëpi të integruara komunitare dhe 1 institucion të veçantë. Aktualisht është shqetësuese kapaciteti i kufizuar për akomodim duke marrë parasysh mbingarkesat, ndërsa shtëpia e të moshuarve ka kriterë për praninë e moshën (65 vjeç e sipër). Përveç kësaj, ka mundësi të disponueshme të akomodimit ditor të ofruara nga OSHC-të. Sido që të jetë, anëtarët e familjeve të PAK kërkojnë zgjidhje afatgjatë për personat me aftësi të kufizuara dhe probleme të shëndetit mendor, ndërsa çështja e akomodimit dhe kujdesi afatgjatë krijon shumë pengesa gjatë ofrimit të asistencës. Veçanërisht sfiduese mbeten rastet e personave me aftësi të kufizuara nën përkujdesjen e anëtarëve të familjes të shtyer në moshuar. Kjo sfidë kërkon vëmendje institucionale të menjëhershme dhe një zgjidhje të qëndrueshme.

Rekomandime:

- Ofrimi ose kontraktimi i shërbimeve të specializuara për personat me aftësi të kufizuara dhe çrregullime të shëndetit mendor nga autoritetet institucionale relevante;
- Realizimi i aktiviteteve avokuese për të diskutuar zgjidhje adekuate për personat me aftësi të kufizuara nën kujdesin e familjarëve apo kujdestarëve të moshuar që nuk janë në gjendje të ofrojnë mbështetjen e duhur;
- Rritja e mbështetjes financiare për të zgjeruara shërbimet sociale të bazuara në komunitet.

Shërbimet e mirëqenies sociale

Ekzistojnë disa çështje për t'u adresuar lidhur me ofrimin e ndihmës sociale për njerëzit me aftësi të kufizuara. Shuma e asistencës sociale vështirë se mund të kontribuojë në mbijetesën e familjeve të PAK që zakonisht jetojnë në kushte shumë të vështira socio-ekonomike. Përveç kësaj, ka standarde të ndryshme për kategoritë në nevojë për përcaktimin e sigurimit të pensioneve, gjë që krijon barriera për trajtim të drejtë.

Procedurat burokratike për ri-aplikim për asistencë sociale çdo gjashtë muaj mbeten sfiduese për shumicën e rasteve të personave me aftësi të kufizuara; kjo paraqet vështirësi për familjet ose kujdestarët e PAD duke marrë parasysh gjendjen e tyre socio-ekonomike dhe infrastrukturën fizike për qasje në ndërtesat publike. Ekzistojnë ndërprerje edhe në asistencën e ofruar sociale - ka periudha kohore kur marrin asistencë dhe periudha të tjera kur nuk ndodh një gjë e tillë.

Përveç kësaj, OSHC-të kanë theksuar nevojën për t'u shqyrtuar vendimet e Komisionit të Ankesave/Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale duke marrë parasysh jo harmoninë potenciale të vendimeve me nevojat e personave me aftësi të kufizuara.

Rekomandime:

- Shqyrtimi i çështjeve procedurale dhe procesi i ankesave për asistencë sociale:
 - *Adresimi i hapësirave ligjore në përcaktimin e veprimeve për raste specifike në konsultime të ngushta me autoritetet locale/punëtorët e parë të linjës dhe OSHC-të, p.sh. në rast vdekjeje të PAK në strehim familjar;*
 - *Rishikimi i procedurave burokratike për ri-aplikim për asistencë sociale çdo gjashtë muaj, e cila mbetet sfiduese për shumicën e rasteve të personave me aftësi të kufizuara;*
 - *Shqyrtimi i vendimeve të Komisionit të Ankesave/MPMS për rastet paraplegjike, ku është vërejtur se vendimi i marrë është në mospërputhje me nevojat e personit, p.sh. nuk është caktuar një kujdestar edhe vlerësohet nga OSHC se është e nevojshme.*

Shërbimet shëndetësore dhe trajtimi afatgjatë

Sistemi i kujdesit shëndetësor në Kosovë vë theks të veçant mbi aftësisë së kufizuar në planet e veprimtimit. Profilizimi, identifikimi i hershëm dhe ndërhyrja te fëmijët me aftësi të kufizuara ose në rrezik për zhvillim të vonshëm nuk ekziston dhe modeli mjekësor i aftësisë së kufizuar është përjetësuar nga profesionistët mjekësorë.

Janë ofruar shërbime shëndetësore për rastet psikiatrike; megjithëse trajtimi mbetet afatshkurtër duke pasur parasysh se zinxhiri i referimit përfundon në qendrat e shëndetit mendor.

Shtëpitë e strehimit për kategori të tilla janë më se të nevojshme. Sa i përket shërbimeve shëndetësore kërkohet më shumë bashkëpunim midis Njësisë së Psikiatrisë, Qendrave për Punë Sociale (QPS), Qendrave të Mjekësisë Familjare, Qendrave të Shëndetit Mendor dhe organizatave joqeveritare që ofrojnë shërbime të specializuara.

Përveç kësaj, shpenzime shtesë janë të nevojshme për rastet në gjendje të rëndë; ndonëse nuk ofrohet mbështetje shtesë institucionale duke pasur parasysh nevojat e tyre specifike.

Rekomandime:

- Të avokohet për asistencë shtesë për të mbuluar nevojat shëndetësore të rasteve të rënda të PAK dhe atyre me çrregullime të shëndetit mendor;
- Krijimi i një strategjie ndërmjet akterëve lokalë për ofrimin e shërbimeve të specializuara shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore.

Qasja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor

Përafërsisht 800 milionë fëmijë në mbarë botën janë të prekur nga gjendja biologjike, mjedisore dhe psikosociale që mund të kufizojnë zhvillimin e tyre kognitiv. Në Evropë, vlerësohet të jenë 15 milionë fëmijë me nevoja të veçanta arsimore⁵. Nga ana tjetër, vetëm 10% e fëmijëve me aftësi të kufizuara përfitojnë nga qasja e duhur në shëndetësi, arsim dhe shërbime sociale⁶. Për përfshirjen sociale, komunat nuk kanë një qasje të integruar ndërsektoriale për të mbuluar shërbimet, në mënyrë që të merren parasysh nevojat e grupeve më të ndjeshme, në veçanti fëmijët. Kosova duhet të sigurojë që fëmijët me aftësi të kufizuara të jenë në gjendje të ndjekin shkollat publike krahas bashkëmohatarëve të tyre. Nevojiten më shumë përpjekje për t'u siguruar fëmijëve me aftësi të kufizuar qasje në arsim cilësor. Grupi i parë i 54 asistentëve për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta u diplomua në qershor të vitit 2018. Aktualisht janë vetëm 83 mësues mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara; ata angazhohen dhe paguhen nga familjet sesa nga sistemi arsimor⁷.

Identifikimi i rasteve të fëmijëve me aftësi të kufizuara që nuk janë të regjistruar në sistemin arsimor mbetet sfida fillestare e institucioneve arsimore. Përveç kësaj, fëmijët me aftësi të kufizuara ndjekin shkollimin me asistentë privatë, duke pasur parasysh që shkollat nuk ofrojnë mësues mbështetës. Shkollat gjithashtu janë të kufizuara në posedimin e infrastrukturës adekuate, si dhe dhomat burimore dhe materialet didaktike të nevojshme për zhvillimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Mësimdhënësit kanë nevojë për aktivitete për ngritjen e kapaciteteve sa i përket aftësisë së kufizuar dhe arsimin gjithëpërfshirës, ndërsa mungesa e planeve individuale të mësimdhënies paraqet një sfidë për t'u adresuar më tej.

Autoritetet duhet të rrisin përpjekjet për të integruar me efikasitet fëmijët me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore dhe të marrin në konsideratë nevojat e tyre gjatë gjithë arsimimit të tyre.

Rekomandime:

- Krijimi i një ekipi në terren për të identifikuar rastet e fëmijëve me aftësi të kufizuara që nuk janë të regjistruar në sistemin arsimor si dhe rasteve të braktisjes së shkollës;
- Rritja e numrit të asistentëve për fëmijë me aftësi të kufizuara të përfshirë në shkolla të rregullta në mënyrë që të mbështeten nevojat e tyre arsimore;
- Krijimi i dhomave burimore të pajisura me materiale didaktike dhe me teknologji asistive në të gjitha shkollat;
- Hartimi i planeve individuale arsimore për çdo fëmijë me aftësi të kufizuar;
- Organizimi i aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve për stafin mësimdhënës mbi aftësinë e kufizuar dhe arsimin gjithëpërfshirës;
- Kontraktimi i shërbimeve shtesë të specializuara (p.sh. Psikolog dhe Logoped) të nevojshme për avancimin e fëmijëve;
- Ngritja e vetëdijes së komunitetit lidhur me edukimin e hershëm të fëmijës;
- Ngritja e vetëdijes të bashkëmohatarëve, prindërve dhe stafit mësimdhënës mbi çrregullimet e shëndetit mendor dhe aftësinë e kufizuar.

⁵ European Commission (2013). Support for Children with Special Educational Needs.

⁶ Coalition of NGOs for Child Protection – KOMF (2017). Child Protection Index 2.0: Measuring government efforts to protect girls and boys.

⁷ European Commission. Kosovo Report (2019)

Bashkëpunimi ndërinstytucional dhe roli i OSHC-ve

Bashkëpunimi ndër-institucional horizontal dhe vertikal është theksuar në të gjitha takimet e grupeve punuese. Në përgjithësi, ekziston mungesa e koordinimit dhe bashkëpunimit të duhur ndërmjet institucioneve në nivel lokal dhe qendror, si dhe ndërmjet autoriteteve institucionale dhe OSHC-ve si ofrues të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara dhe problemet e shëndetit mendor.

Përveç kësaj, *sfidat në intervenim* u sollën nga të gjithë ofruesit e shërbimeve me theks të veçantë në QPS-të. Ka pak komuna që kanë hartuar rregulloret komunale dhe planet e veprimit për të shfrytëzuar në mënyrë efektive të gjitha burimet për ofrimin e shërbimeve; por shumica kanë raportuar nevojën për përmirësimin e nivelit të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet të gjithë akterëve të përfshirë, institucionet lokale apo nga shoqërisë civile.

Zyrtarët e parë të linjës gjithashtu kanë raportuar *mungesë të resurseve njerëzore adekuate*, pra psikologë dhe punëtorë social, çka edhe krijon barriera në asistimin e rasteve në nevojë për shkak të ngarkesës së madhe të punës ose për shkak të mungesës së shërbimeve të duhura. QPS-të sfidohen vazhdimisht me kufizime për të ndihmuar rastet e tyre për shkak të mungesës së një fondi emergjent për ndërhyrje. Për më tepër, *kushtet jo adekuate të punës* u theksuan nga praktikuesit që përfaqësonin të dyja, institucionet lokale si dhe shoqëria civile.

Konsistenca e dobët në ofrimin e shërbimeve për shkak të mungesës së burimeve financiare është raportuar nga OSHC-të. Nuk ka qëndrueshmëri në sigurimin e shërbimeve ekzistuese duke marrë parasysh që mbështetja nga autoritetet lokale nuk është konsistente. Megjithatë ekziston Rregullorja MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat për Financimin Publik të OJQ-ve, procedurat dhe metodat e financimit nuk sigurojnë konsistencë në shërbime. Përkundër që thirrjet për aplikim përfshijnë projekte 1-vjeçare, duke marrë parasysh kohëzgjatjen dhe vonesën e procedurave, ata mund të të mbështesin vetëm disa muaj të vitit për implementim. Duke marrë parasysh çështjet e financimit, qendrat ditore zakonisht ofrojnë shërbime me orar të shkurtuar.

Rekomandime:

- Përmirësimi i koordinimit ndërinstytucional dhe rritja e mbështetjes për institucionet e nivelit lokal:
 - *Përmirësimi i koordinimit ndërinstytucional midis niveleve qendrore (ministrive) dhe nivelit lokal (komunave);*
 - *Sigurimi i një fond specifik për ndërhyrjet emergjente për QPS-të;*
 - *Sigurimi i QPS-ve me burime të përshtatshme njerëzore (p.sh. psikolog, punonjës socialë dhe profesionist të tjerë të shëndetit mendor) dhe përmirësimi i kushtet e punës;*
 - *Inicimi i hartimit të rregulloreve komunale dhe planeve të veprimit për PAK.*
- Përcaktimi i standardeve minimale, licencimi dhe financimi i OShC-ve, si dhe përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe shoqërisë civile.
 - *Përmirësimi i bashkëpunimit me OSHC-të në drejtim të licencimit të shërbimeve sociale dhe financimit të aktiviteteve të tyre, veçanërisht në rastet e shërbimeve që nuk ofrohen nga autoritetet institucionale;*
 - *Rritja e buxhetit aktual të kufizuar komunal për aktivitetet e OShC-ve lokale që punojnë me personat me aftësi të kufizuara dhe problem të shëndetit mendor.*


Paragjykimet dhe stigmatizmi

Ekziston një tendencë e përgjithshme e shoqërisë për të neglizhuar dhe shtypur çështjet e aftësisë së kufizuar dhe shëndetit mendor. Çështjet e paragjykimeve dhe stigmës mbeten signifikante gjatë ofrimit të asistencës për PAK. Ka një perceptim të përgjithshëm në mesin e komunitetit se PAK dhe personat me çrregullime të shëndetit mendor janë të paaftë të merren me kërkesat e jetës së përditshme ose të punojnë dhe marrin pjesë në jetën shoqërore. Personat me vonesa të lehta të zhvillimit mendor nuk pranohen në trajnime të ndryshme profesionale; ndërsa të tjerët mbeten të izoluar për shkak të stigmës dhe besimeve negative sociale. Përveç kësaj, personat me dëmtime intelektuale mbeten si kategoria me më së paku vëmendje në shoqëri sa i përket ofrimit të shërbimeve. Perceptimet negative janë gjithashtu të pranishme në mesin e zyrtarëve që ofrojnë shërbimet e tyre.

Paragjykimet dhe stigmatizmi janë të pranishëm jo vetëm në komunitet; është gjithashtu e zakonshme në mesin e anëtarëve të familjes, si dhe në mjediset shkollore të bashkëmoshatarët, mësuesit dhe prindërit.

Rekomandime:

- Ngritja e vetëdijes të anëtarët e familjes në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe trajtimin e hershëm, si dhe këshillimin e prindërve ose kujdestarëve për trajtimin e aftësisë së kufizuar;
- Avokimi për një procedurë efektive dhe efikase të ndërhyrjes në rastet e referimit
- Ngritja e vetëdijes së opinionit publik mbi aftësinë e kufizuar dhe shëndetin mendor, si dhe aftësitë dhe shkathtësitë e personave që i përkasin këtyre kategorive;
- Fillimi i një rrjeti të OShC-ve për të zbatuar aktivitete të përbashkëta të ngritjes së vetëdijes dhe avokimit; kjo nuk mund të arrihet vetëm në nivelin e projekteve.
- Ngritja e kapaciteteve të autoriteteve përkatëse dhe OSHC për ngritje të fondeve dhe implementim të projekteve.



Ky dokument është realizuar me asistencën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtjet e këtij dokumenti janë përgjegjësi vetëm e Caritas-it dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohen si reflektim i pozicionit të Bashkimit Evropian.